

## KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTAVE

Sot më datë 17 Janar 2024, në Tiranë, midis palëve të mëposhtme:

### Nga njëra anë:

1. Znj. Nertila Kole, shtetase shqiptare, lindur më 13.03.1977, në Fier, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H75313075D dhe nr. 028513114, këtu e në vijim referohet si "Shitësi";

### Nga ana tjetër:

2. Z. Albatrit Balaj, shtetas shqiptar, lindur më 05.06.1990, në Republikën e Kosovës, mbajtës i pasaportës me nr. personal J00605144D dhe nr. BD9222191, këtu e në vijim referohet si "Blerësi",

Lidhet kjo Kontratë Shitje me përmbajtje si më poshtë vijon:

- A. Shitësi është pronar i kuotave në shoqërinë "Travel Hub Solutions" SHPK, me numër (NUIS) L41630002R, ("Shoqëria"), që përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë ("Kuota e Shitur");
- B. Shoqëria është ortakë dhe zotëron 60% të kuotave në shoqërinë "ALBAWINGS" SHPK, me numër NUIS L51418010M ("Filiali").

Shitësi dëshiron t'i shesë Kuotën e Shitur Blerësit dhe Blerësi pranon kushtet e mëposhtme.


ATËHERË: Lidhet kjo Kontratë Shitje midis palëve me përmbajtje si më poshtë vijon:

### 1. OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është shitja dhe transferimi i Kuotës së Shitur në pronësi të Shitësit në Shoqërinë "Travel Hub Solutions" SHPK, e cila përfaqëson 100% (njëqind për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë ("Kuota e Shitur").
- 1.2 Pronësia e Kuotës së Shitur i kalon Blerësit në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate, dhe Kuota e Shitur do të përfitohet së bashku me të drejtat dhe përfitimet e lidhura me të, me përjashtim të të drejtave të përcaktuara në nenin 6 të cilat do të mbeten në favor të Shitësit.

### 2. PRONËSIA E KUOTËS SË SHITUR

- 2.1 Kuota e Shitur transferohet dhe kalon në pronësi të Blerësit në datën e regjistrimit të Kontratës në Qendrën Kombëtare të Biznesit sipas ekstraktit tregtar.



### 3. SHPËRBLIMI

- 3.1 Shitja e Kuotës së Shitur sipas kësaj Kontrate bëhet në favor të Blerësit kundrejt një shpërblimi në vlerën 1 euro.

### 4. REGJISTRIMI I TRANSFERIMIT DHE PJESËMARRJA NË KAPITAL

- 4.1 Pronësia mbi Kuotën e Shitur i kalon Blerësit në datën që Kontrata regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, datë në të cilën Blerësi do të konsiderohet si ortak i vetëm i Shoqërisë. Blerësi detyrohet të njoftojë/regjistrojë këtë Kontratë në çdo autoritet tjetër shqiptar të nevojshëm.

### 5. DEKLARIMET, DETYRIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

- 5.1. Shitësi deklaron dhe garanton ndaj Blerësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet (“**Garancitë e Shitësit**”) në vijim janë të vërteta dhe të sakta në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

- (a) Shitësi ka të gjithë të drejtat dhe zotësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate. Shitësi angazhohet të kryejë çdo veprim të nevojshëm për të rregulluar/saktësuar numrin e kuotave të Shoqërisë sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9901 Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

- (b) Pronësia e Kuotës së Shitur:


- i. Shitësi është pronari i vetëm ligjor i Kuotës së Shitur;
- ii. Kuota e Shitur është nënshkruar dhe emetuar në mënyrën e duhur dhe është paguar plotësisht;
- iii. Kuota e Shitur dhe të gjitha të drejtat e lidhura me të janë të lira nga cdo lloj pengu apo barre të cfarëdo natyre qoftë.

- (c) Shitësi siguron që Shoqëria është ekzistuese dhe e vlefshme, e organizuar rregullisht dhe e themeluar sipas ligjeve të Shqipërisë.

- (d) Shoqëria është e pajisur me të gjitha licencat, lejet, autorizimet dhe pëlqimet e kërkuara për kryerjen e aktivitetit tregtar të treguar në objektin e saj.


- (e) Shoqëria ka bërë deklarinë në lidhje me pronarin përfitues fundor në përputhje me kërkesat ligjore dhe nuk është dhe nuk do jete subjekt penaliteti ndaj organeve shtetërore në lidhje me këtë deklarinë.

- 5.2 Shitësi deklaron dhe pranon që sipas vendimit të asamblese të shoqërisë “Travel Hub Solution” me datë 03.01.2024 miratoi shpërndarjen përkatëse të dividendit nga Fitimet Pashperndara të periudhave të shkuara në vlerën bruto prej 42,452,522.00 Leke. Vlera neto e dividendit të pagueshem do të kompensohet me balancën e hapur të “Të drejtave të arkëtueshme nga Ortaku N.Kole”, e cila është raportuar rregullisht në Pasqyrat Financiare për vitin financiar të mbyllur më 31.12.2023 si “hua afatshkurtër ortaku” në vlerën prej 39,056,320.00 Lekë. Shitësi deklaron se do të lërë gjendje të mjaftueshme në llogarinë likujduese bankare të Shoqërisë me kusht për të përmbushur të gjitha detyrimet tatimore që lindin nga deklarimi i tatimit mbi dividendin, tatim efektiv i pagueshem prej datës 01.02.2024 deri më 15.02.2024 në vlerën 3,396,200.00 Leke.



## 6. DEKLARIMET, DETYRIMET DHE GARANCITË E BLERËSIT

- 6.1. Blerësi, paraqet dhe garanton ndaj Shitësit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklarimet në vijim janë të vërteta dhe të sakta në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 6.2. Blerësi ka të gjitha të drejtat dhe zotësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- 6.3. Blerësi pranon që të drejtat dhe detyrimet e tij në lidhje me Kuotën në Shitje dhe në përgjithësi me pjesëmarrjen e tij në kapitalin e Shoqërisë, do të udhëhiqen nga interesi më i lartë i shoqërisë dhe ortakëve të saj sipas statutit dhe akteve ligjore në fuqi.
- 6.4. Në rast se Blerësi nuk përmbush detyrimet e tij në këtë Kontratë dhe/ose shkel deklarimet dhe garancitë e dhëna në këtë nen, atëherë Shitësi ka të drejtë të kërkojë çdo humbje apo dëmshpërblim tjetër si pasojë e mospërmbushjeve apo shkeljeve të Blerësit.
- 6.5. Blerësi deklaron dhe pranon që të gjitha fitimet e realizuara dhe/ose të pashpërndara të Shoqërisë të akumuluar deri në datën e shitjes në vlerën prej **35,703,677.00 Lekë** si fitime të pashpërndara të raportuara deri më 31.12.2022 (78,156,199.00 Leke) minusuar me vlerën e shpërndarë të dividendit sipas vendimit të asamblese me datë 03.01.2024 (42,452,522 Leke), dhe fitimet neto të periudhës 01.01.2023 – 31.12.2023, të vlerësuara **1,179,652.00 Lekë**, të cilat janë raportuar në pasqyrat finale për vitin 2023, i takojnë Shitësit dhe do të shpërndahen në favor të tij sa më shpejt të jetë e mundur. Blerësi deklaron dhe pranon që balanca e hapur e të "Të drejtave të arkëtueshme nga Ortaku N.Kole", e cila është raportuar rregullisht në Pasqyrat Financiare për vitin financiar të mbyllur më 31.12.2023 si "hua afatshkurtër ortakut" në vlerën prej 39,056,320.00 Lekë nuk do të prodhojë kamata ose interes dhe do të kompensohet me një vlerë neto të njëjtë të dividendit të deklaruar dhe të shpërndarë Shitësit sipas nenit 5.2. Blerësi angazhohet të kryejë çdo veprim të nevojshëm për të deklaruar dhe paguar tatimin e dividendit brenda datës 15.02.2024. Blerësi angazhohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të kryer kompensimin e detyrimeve reciproke brenda afatit të mësipërm.
- 6.6. Blerësi deklaron dhe pranon që të gjitha llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë të lidhura me klientët e paarkëtuar deri në datën 31.12.2023 i takojnë Shitësit, dhe Blerësi angazhohet të informojë Shitësin menjëherë dhe të kryejë çdo veprim të nevojshëm për t'i kaluar këto fonde në favor të Shitësit si shpërndarje të fitimeve mbetura të pashpërndara brenda kohës më të shkurtër të mundshme sapo ato bëhen të disponueshme për Shoqërinë. Konkretisht pretendimet e Shitësit mbi llogaritë e arkëtueshme më datë 31.12.2023, të pritshme për t'u arkëtuar janë: "Kliente të arketueshem Albawings shpk (L51418010M)" për **34,236,903.00 Lekë** dhe "Te tjera llogari të arketueshme" nga Parapagime të Tatimit mbi Fitimin sipas deklaratës FDP viti fiskal 2023 për **2,571,816.00 Lekë**.
- Për të shmangur çdo dyshim, të gjitha ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe/ose nga investimet në Shoqëri ose në filialet e kësaj të fundit të kryera duke filluar nga data 01.01.2024 i takojnë Blerësit.
- 6.7. Blerësi deklaron, pranon dhe angazhohet që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që menaxhimi i Shoqërisë të rregullohet në mënyrë të atillë që Shitësi të vijojë të jetë administrator i Shoqërisë deri në 2 (dy) javë pas kalimit të pronësisë së kuotave me qëllimin e vetëm që çdo veprim në llogaritë ekzistuese ose të ardhshme të Shoqërisë në bankat e nivelit të dytë të kryhet me nënshkrimin e përbashkët ose miratimin me shkrim ose elektronik të Shitësit.
- 6.8. Blerësi deklaron që e pranon Kuotën e Shitur dhe Shoqërinë (duke përfshirë Filialin) në gjendjen në të cilën ndodhet. Megjithatë, Shitësi do të garantojë çdo detyrim financiar përfundimtar të Shoqërisë ndaj autoriteteve tatimore ose palëve të treta furnitore i cili rezulton ose ka lidhje me aktivitetin e mëparshëm deri në datën e shitjes dhe garanton mbulimin e këtij detyrimi me kuotat e saj në Filial.



## 7. KOSTOT

- 7.1 Secila Palë duhet të mbajë përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumenteve të detyrueshme ligjërishit ose sipas kësaj Kontrate.
- 7.2 Cdo tarifë, taksë ose tatim që duhet paguar, nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i transferimit të Kuotës së Shitur, është në ngarkim të Shitësit.

## 8. LIGJI I ZBATUESHEM

- 8.1 Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar, dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.

## 9. JURIDIKSIONI

- 9.1 Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë përsa i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë së saj do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## 10. TË NDRYSHME DHE SHTESA

- 10.1 Asnjë ndryshim, shtesë, ose tjetërsim i kësaj Kontrate nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk është me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose për llogari të Palëve.
- 10.2 Në rast se në çdo kohë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e pavarur nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e Palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontratës ose të Kontratës në tërësi, e cila do të interpretohet dhe do të zbatohet në mënyrë të pavarur.

## 11. GJUHA, KOPJET E KONTRATËS DHE HYRJA NË FUQI

- 11.1 Kjo Kontratë hartohet në tre kopje në gjuhën shqipe, një për secilën palë dhe një për Shoqërinë, ku secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën Kontratë.

Shitësi

Znj. Nertila Kole

Nertila Kole  


Blerësi

Z. Albatrit Balaj

Albatrit Balaj  


Bashkëshorti i znj. Nertila Kole, z. Gentian Kole jep miratimin për nënshkrimin e kësaj kontrate.

Gentian Kole GENTIAN KOLE

